

KOMISIONERI

për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale




INFORMIM

DHE

PRIVATËSI

Revista nr. 7



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 7

Qershor 2019

Përmbajtja

Delegacioni i BE në Shqipëri, mbështetje për Zyrën e Komisionerit	faqja 3
Modernizimi i legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale, bashkëpunimi me EDPS	faqja 4
Zyra e Komisionerit vlerësohet si institucioni më transparent për vitin 2018 nga Qendra “Res Publica”	faqja 5
Marrëveshja me EUROJUST, “Planveprimi” mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Zyrës së Komisionerit	faqja 5
28 Janar - Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, prezantohet iniciativa “Luaj dhe mëso - Happy Onlife”	faqja 6
“Informim dhe Privatësi”, trajnim në Universitetin “Epoka”	faqja 7
Konferenca e 41-të Ndërkombëtare e Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë	faqja 8
Komiteti Ekzekutiv i Konferencës Ndërkombëtare	faqja 9
Bordi Konsultativ Kombëtar ICDPPC - 2019	faqja 9
Samiti Global i Privatësisë	faqja 10
Bashkëpunimi me Autoritetin e Britanisë së Madhe për organizimin e Konferencës Ndërkombëtare	faqja 11
Trajnim me stafin e Zyrës së Komisionerit	faqja 11
Kuvendi miraton Rezolutën për vlerësimin e punës së Zyrës së Komisionerit për vitin 2018	faqja 12
Forumi “Mbrojtja e të Dhënave personale, sfidat e ligjit për biznesin”	faqja 12
Konferenca e Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave	faqja 13
“Pyet Shtetin - Merr Përgjigje”, fushata ndërgjegjësuese për të drejtën e informimit	faqja 14
Transparenca e institucioneve të arsimit të lartë	faqja 14
Takim me Zëvendëspresidentin e Parlamentit Evropian, z. Fabio Massimo Castaldo	faqja 15
Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave dhe kodet e sjelljes sipas GDPR	faqja 15

Revista “Informim Dhe Privatësi”

Redaksia: Irma Arapi, Alketa Koja, Redi Skënderaj, Erald Mullaraj, Elinda Sulejmani

**Përgatitet dhe botohet nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Print:

Botime F.L.E.SH

Qershor 2019

Delegacioni i BE në Shqipëri, mbështetje për Zyrën e Komisionerit

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, priti në një takim pune Kreun e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, z. Luigi Soreca. Gjatë tij u diskutua për veprimtarinë e institucionit në kuadër të mbikëqyrjes së legjislacionit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale; procesin e integritimit në përafrimin e kuadrit rregullator shqiptar me atë evropian në fushën e mbrojtjes së të dhënave; si dhe për zhvillimin e **Konferencës së 41-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë** në Tiranë, më 21-24 tetor 2019.



Komisioneri Dervishi u shpreh se krijimi i Autoritetit është shprehje e vullnetit dhe mbështetje që BE ka dhënë për Shqipërinë. Ai prezantoi arritjet kryesore dhe fokusin e punës së Zyrës së Komisionerit gjatë viteve të fundit. Ndërsa, theksoi se hyrja në fuqi e ligjit "Për të drejtën e informimit" ka ndryshuar në mënyrë rrënjësore panoramën e transparencës së Autoriteve Publike shqiptare, e nga ana tjetër, ligji "Për mbrojtjen e të dhënave personale" është instrument i testuar dhe i besueshëm për garantimin e privatësisë së qytetarëve.

Zyra e Komisionerit do të nisë së shpejti zbatimin, në kuadër të Programit IPA 2017, e projektit të binjakëzimit **"Ndërtimi i institucioneve për harmonizimin me acquis të BE për të përmbushur kriteret ekonomike lidhur me mbrojtjen e të dhënave"**. Nëpërmjet këtij projekti do të përafrohen tërësisht në legjislacionin shqiptar Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) dhe Direktiva e Policisë (2016/680), duke siguruar standardet më të larta në këtë fushë edhe për qytetarët shqiptarë. Komisioneri Dervishi e njohu z. Soreca edhe me përgatitjet për organizimin e Konferencës së 41-të Ndërkombëtare.

Ambasadori Soreca vlerësoi maksimalisht veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit dhe garantoi mbështetjen e plotë të Delegacionit në të ardhmen për institucionin. Ai theksoi se mbrojtja e të dhënave personale, në vetvete, ndihmon në procesin e sundimit të ligjit në Shqipëri. Sipas Kreut të Delegacionit, sfidat e epokës digjitale janë të shumëllojshme dhe transpozimi i legjislacionit të ri evropian në këtë fushë në kuadrin rregullator shqiptar, është një proces shumë sinjifikativ, për të cilin BE ka aprovuar edhe projektin përkatës me një vlerë prej 400 mijë eurosh. Po ashtu, Ambasadori nënvizoi si shumë të rëndësishëm thellimin e bashkëpunimit të institucioneve shqiptare të drejtësisë e policisë me ato evropiane në këtë fushë. Z. Soreca e cilësoi mbajtjen e Konferencës së 41-të Ndërkombëtare në Tiranë, si shprehje të konsolidimit të rolit të Zyrës së Komisionerit si brenda dhe jashtë vendit.



Modernizimi i legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale, bashkëpunimi me EDPS

Me ftesë të Mbikëqyrësit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave (European Data Protection Supervisor), Komisioneri, z. Besnik Dervishi, shoqëruar dhe nga pjesëtarë të stafit të Autoritetit zhvilluan një takim pune në këtë institucion të BE. Agjenda e takimit kishte të bënte me dy komponentë, së pari me procesin integruar në kuadër të transpozimit të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (2016/679) dhe të Direktivës së Policisë (2016/680) në legjislacionin shqiptar; si dhe shkëmbim informacioni e diskutime në kuadër të organizimit të edicionit të 41-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC). Vlen të theksohet fakti se EDPS ishte organizatori, në bashkëpunim me Autoritetin bullgar, tetorin e vitit të kaluar, të edicionit të 40-të të kësaj Konferencë. Mbikëqyrësi Evropian është anëtar, ashtu si edhe Komisioneri, në forumin drejtues të saj, Komitetin Ekzekutiv.



Z. Besnik Dervishi dhe stafi u pritën fillimisht nga Drejtori i Përgjithshëm i EDPS, z. Leonardo Cervera Navas dhe nga stafi përgjegjës për organizimin e Konferencës së 40-të Ndërkombëtare, ndërsa në vijim u prit nga Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave, z. Giovanni Buttarelli. Z. Dervishi falënderoi homologun për ftesën dhe për gatishmërinë për të bashkëpunuar me Zyrën e Komisionerit. Ai bëri një panoramë të planifikimit dhe realizimeve të kryera e të pritshme në kuadër të organizimit të edicionit të radhës të Konferencës.

Komisioneri e njohu Mbikëqyrësin me kuadrin ligjor shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale, kompetencat e Autoritetit, si dhe bëri një përmbledhje të aktiviteteve të saj, duke u fokusuar në hapat e ndërmarrë për nisjen e procesit të harmonizimit të legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale me atë të BE. Nga ana e tij, z. Buttarelli shprehu angazhimin e plotë të institucionit që drejton për të vijuar mbështetjen për Zyrën e Komisionerit në të dy iniciativat e mësipërme, duke nënvizuar rëndësinë që ato mbartin edhe në kontekstin e integritetit të vendit. Diskutimet në vijim u fokusuan në shkëmbimin e eksperiencës në nivel teknik me stafin e EDPS.



Zyra e Komisionerit vlerësohet si institucioni më transparent për vitin 2018 nga Qendra “Res Publica”

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është vlerësuar si institucioni shqiptar më transparent për vitin e kaluar nga

organizata e shoqërisë civile “Res Publica”. Ky është një vlerësim i rëndësishëm për veprimtarinë e institucionit dhe njëkohësisht, nxitje për përpjekjet e tij në konsolidimin e kulturës së përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së Autoriteteve Publike.

Qendra publikoi Raportin “E drejta e informimit 2018”, ku është analizuar dhe vlerësuar ecuria e përmbushjes së detyrimeve të ligjit 119/2014. Zyra e Komisionerit do t’i mbajë në konsideratë gjetjet e këtij Raporti në punën e saj. Organizata ndau edhe 5 çmime të tjera për transparencën sipas kategorive, ku Kolegji i Posaçëm i Apelit u shpall fitues në atë të institucioneve kushtetuese dhe të pavarura; Ministria e Kulturës nga pushteti qendror; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Prokuroria e Përgjithshme nga sistemi i drejtësisë; Bashkia Shkodër nga organet e vetëqeverisjes vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor nga institucionet ekzekutive të varësisë.

Marrëveshja me EUROJUST, “Planveprimi” mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Zyrës së Komisionerit

Mbrojtja e të dhënave personale në kuadër të shkëmbimit të informacionit për qëllime të hetimit dhe ndjekjes penale është një nga kolonat e rëndësishme të “Marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST”, të ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. 113/2018. Autoriteti zbatues i kësaj marrëveshje nga pala shqiptare është Prokuroria e Përgjithshme dhe në përmbushje të detyrimeve të saj në fushën e mbrojtjes së të dhënave, znj. Arta Marku dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, nënshkruan një “Planveprimi”.

Të dy këto institucione kanë ngritur një grup pune për të vlerësuar përpunimin e të dhënave personale në veprimtarinë e prokurorisë në nivel qendror dhe vendor, si dhe për të adresuar të gjitha problematikat që do të konstatohen në këtë proces. Zyra e Komisionerit asiston organin e akuzës në zbatimin e standardeve më të larta për masat tekniko-organizative për sigurinë e të dhënave. Po bashkëpunohet për përshtatjen e Rregullores së Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Prokurorisë së Përgjithshme me detyrimet specifike të Marrëveshjes me EUROJUST.

Në tjetër pikë me rëndësi e “Planveprimit” është edhe krijimi i “Regjistrit për komunikimet mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe EUROJUST”. Ky dokument është një mekanizëm për garantimin, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar të fushës, të të drejtave të qytetarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së organit të akuzës. Njëkohësisht, “Planveprimi” ka përcaktuar dhe afate konkrete në realizimin e gjitha këtyre masave.



28 Janar - Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, prezantohet iniciativa “Luaj dhe mëso – Happy Onlife”



Në 28 Janar, në Ditën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Zyra e Komisionerit prezantoi nismën “Luaj dhe mëso – Happy Onlife”. Aktiviteti prezantues u mbajt në mjediset e shkollës 9-vjeçare “Kosova” me nxënës e mësues ku kjo iniciativë është promovuar, me mbështetjen dhe koordinimin e Drejtorisë Arsimore të Tiranës.

Komisioneri, z. Besnik Dervishi, vlerësoi rëndësinë e kësaj date, për edukimin e brezit të ri me njohuri të plota për garantimin e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave të tyre personale, sidomos gjatë përdorimit të mjedisit digjital. Aktivitetin e përshëndetën të ftuarit e nderit, znj.

Vasillika Hysi, Nënkryetare e Kuvendit; z. Olsi Dekovi, Zv/kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës; z. Claudio Pala, përfaqësuesi i Prezencës së OSBE dhe z. Aurelian Juliard, Përfaqësues i Delegacionit të BE.

Nxënës nga secila prej shkollave pjesëmarrëse në këtë nismë të Zyrës së Komisionerit: “Kosova”, “E Kuqe”, “Jeronim de Rada”, “Edith Durham”, “Emin Duraku” dhe “Dora D’Istria”, zhvilluan një demonstrim të lojës. Ajo është përgatitur nga Qendra e Bashkuar Kërkimore e Bashkimit Evropian (Joint Research Centre) për grup-moshën 8-14 vjeç. Loja “Happy Onlife” ka për qëllim ndërgjegjësimin dhe zgjerimin e njohurive për mbrojtje efektive nga fenomenet negative si bullizmi, kontaktet e



padëshiruara në internet apo vjedhja e identitetit digjital, sidomos në rrjetet sociale. Nga studimet e kohëve të fundit, si në Shqipëri ashtu edhe në botë, rezulton se të rinjtë janë gjithnjë e më shumë përdorues të teknologjive digjitale, rrjedhimisht dhe më të ekspozuar ndaj rreziqeve në internet.

Prej 2006, 28 Janari është vendosur si “Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale” nga Këshilli i Evropës, ndërsa në botë njihet si “Dita e Privatësisë”.

“Informim dhe Privatësi”, trajnim në Universitetin “Epoka”

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Universitetin “Epoka” zhvilluan trajnimin me temë “Informim dhe Privatësi”, ku pjesëmarrës ishin 60 studentë dhe staf akademik e administrativ. Takimi u mbajt në kuadër të aktiviteteve për 28 Janarin - Ditën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale.



Komisioneri, z. Besnik Dervishi theksoi rëndësinë e bashkëpunimit tashmë të konsoliduar të Autoritetit me institucionet e arsimit të lartë në njohjen e legjislacionit, për më shumë ndërgjegjësim dhe edukim të shoqërisë për respektimin e të drejtave të qytetarëve. Në emër të Universitetit “Epoka” përshëndeti z. Nituon Mulleti, drejtues i Departamentit të Drejtësisë.



Temat e trajtuara në këtë aktivitet ishin njohja me legjislacionin shqiptar të mbrojtjes së të dhënave personale dhe veprimtarinë e kompetencat e Zyrës së Komisionerit. Njëkohësisht, në këtë modul u prezantuan edhe risitë e Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave në BE (GDPR). Në trajnim u prezantuan detyrimet e “kontrolluesit” që e ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorin e arsimit të lartë (publik apo privat) dhe eksperiencën e institucionit në këtë fushë. Po ashtu, iu kushtua vëmendje mbrojtjes së të dhënave personale në raport me përdorimin e sistemeve të videosurvejimit (CCTV), të drejtave të “subjektit të të dhënave” dhe detyrimeve të “kontrolluesit”. Gjithashtu, për të pranishmit u prezantua edhe tematika e mbrojtjes së të dhënave personale në raport me rrjetet sociale, si dhe njohuri e risi rreth inteligjencës artificiale. Pjesë tjetër e këtij trajnimi ishte edhe njohja me legjislacionin për të drejtën e informimit, rolin e funksionet e koordinatorit, programin e transparencës së Autoriteteve Publike, si dhe me raste praktike nga veprimtaria e Zyrës së Komisionerit në këtë fushë.



Konferenca e 41-të Ndërkombëtare e Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë

Zyra e Komisionerit, si organizatori i Konferencës së 41-të Ndërkombëtare (ICDPPC) në Tiranë, më 21-24 tetor 2019, prezantoi në fund të muajit maj faqen e dedikuar të internetit të këtij aktiviteti www.privacyconference2019.info.



41ST INTERNATIONAL CONFERENCE
OF DATA PROTECTION AND PRIVACY COMMISSIONERS

Elementi identifikues dhe përfaqësues i Konferencës dhe faqes është "*Anija Liburne*". Ajo simbolizon pikëtakimin mes trashëgimisë kulturore shqiptare dhe zhvillimit modern teknologjik – "*Në një det me të dhëna, Liburna lundron e sigurt*".

Faqja e internetit shërben si platforma kryesore e informacionit dhe ndërlidhjes mes pjesëmarrësve në këtë aktivitet të përvitshëm: Autoritetet kombëtare/rajonale; përfaqësuesit e botës akademike; atyre nga organizatat e shoqërisë civile; nga rrethet e biznesit apo medias. Faqja është konceptuar në seksione të posaçme për organizatën (ICDPPC), organet e saj drejtuese, anëtarët dhe dokumentet që ajo miraton; për përmbajtjen e edicionit të 41-të të Konferencës; regjistrimin e pjesëmarrësve; si dhe informacione me karakter praktik e informativ, si dhe potencialin turistik të Tiranës dhe Shqipërisë.

Konferenca e 41-të Ndërkombëtare do të mbahet në mjediset e Pallatit të Kongreseve. Tradicionalisht, ky forum i zhvillon punimet në dy sesione. Në dy ditët e para mbahet **Sesioni i Mbyllur**, ku pjesëmarrës janë delegacionet e Autoriteteve anëtare/vëzhguese të Konferencës. Në dy ditët e tjera mbahet **Sesioni i Hapur**, me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve nga bota akademike, nga organizatat e shoqërisë civile, kompanive të ndryshme nga sektori privat, media, etj. Konferenca Ndërkombëtare (ICDPPC) është forumi më i lartë dhe më i rëndësishëm i bashkëpunimit e koordinimit mes Autoriteteve botërore mbikëqyrëse të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky aktivitet prestigjioz zhvillohet për herë të parë në Shqipëri dhe për më tepër, për herë të parë në rajonin e Ballkanit Perëndimor.



Puna përgatitore për organizimin e Konferencës ka nisur që në vjeshtën e vitit të kaluar, ku Zyra e Komisionerit po bashkëpunon ngushtë me shumë institucione shtetërore dhe me subjekte të sektorit privat. Njëkohësisht, Autoriteti është në kontakt të vazhdueshëm me partnerët ndërkombëtarë në informimin për ecurinë e përmbushjes së aspekteve tekniko-organizative e logjistike, ashtu edhe për përcaktimin e përmbajtjes së këtij aktiviteti madhor. Konferenca Ndërkombëtare është një rast unikal për promovimin e vlerave më të mira institucionale, të mikpritjes dhe të trashëgimisë kulturore dhe në përgjithësi, për konsolidimin e imazhit pozitiv të vendit tonë në botë.



Komiteti Ekzekutiv i Konferencës Ndërkombëtare

Komiteti Ekzekutiv i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC), ka zhvilluar gjatë 6-mujorit të parë të 2019 disa takime. Në atë të mbajtur në muajin mars u diskutua për të ardhmen e Konferencës dhe raportet me partnerët e jashtëm; marrëdhëniet dhe përfaqësimi i Konferencës në forumet e tjera të rëndësishme të fushës dhe jo vetëm; u informuan anëtarët e Komitetit Ekzekutiv për ecurinë e veprimtarisë së Grupeve të posaçme të Punës; u miratua ngritja e bazës së të dhënave për bashkëpunimin dhe

ndërveprimin ndërkombëtar ligjzbatues mes Autoriteteve të fushës; u vlerësua krijimi i "Indeksit global të privatësisë" dhe indikatorëve të tij matës; u shqyrtuan modalitetet e reja të konkurrimit dhe përzgjedhjes së fituesve të "Çmimeve Ndërkombëtare të Privatësisë". Komiteti Ekzekutiv vlerësoi dhe dakordësoi aspekte të përmbajtjes së Konferencës së 41-të Ndërkombëtare që mbahet në Tiranë, ndërsa miratoi Planin Strategjik të forumit për periudhën 2019-2021.

Në këtë mbledhje u miratua ngritja dhe përbërja e "Komitetit Këshillimor të Programit të Konferencës së 41-të Ndërkombëtare", i cili bashkëdrejtohet nga z. Peter Hustings (ish-Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave dhe ish-kreu i Autoritetit holandez) dhe z. Besnik Dervishi. Në takim u diskutua për çështje që kanë të bëjnë me drejtimin strategjik të Konferencës Ndërkombëtare, për përmbajtjen e edicionit të 41-të të saj dhe panelistët, si dhe për aspekte tekniko-organizative. Komiteti Ekzekutiv është forumi drejtues i Konferencës Ndërkombëtare dhe drejtohet nga znj. Elizabeth Denham, Kreu i Autoritetit të Britanisë së Madhe dhe anëtarë të tij janë z. Daniel Therrien, Komisioner i Kanadasë; znj. Angelene Falk, Komisionere e Australisë; z. Giovanni Buttarelli, Kreu i EDPS; z. Ventislav Karadjov Komisioner i Bullgarisë, znj. Marguerite Ouedraogo Bonane, Komisionere e Burkina Fasos, z. Raymund Enriquez Liboro, Komisioner i Filipineve; z. Besnik Dervishi; si dhe në cilësinë e vëzhguesit kreu i Autoritetit meksikan, z. Francisco Javier Acuña Llamas.

Bordi Konsultativ Kombëtar i ICDPPC - Tirana 2019

Nën drejtimin e Komisionerit, z. Besnik Dervishi, u mbledh Bordi Konsultativ Kombëtar i ICDPPC - Tirana 2019. Të ftuar në cilësinë e anëtarit të tij ishin znj. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit, z. Robert Gajda, Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi, z. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave, nga bota akademike znj. Eralda Methasani Çani e z. Endri Xhina, si dhe z. Fotjon Kosta, Koordinator i Forumit Shqiptar të Qeverisjes së Internetit.



Zyra e Komisionerit, si organizatore e Konferencës së 41-të Ndërkombëtare, themeloi këtë strukturë për diskutimin dhe vlerësimin e hapave tekniko-organizative të këtij aktiviteti. Anëtarët e Bordit shkëmbyen ide e mendime për fokusin e tematikave dhe përmbajtjen e aktivitetit, duke theksuar simjaft të rëndësishme bashkëpunimin e institucioneve shqiptare për mbarëvajtjen e tij. Ata u njohën dhe me ecurinë e përgatitjeve në aspektin logjistik të Konferencës, ku ofruan gatishmërinë e tyre për të kontribuar në këtë drejtim.

Samiti Global i Privatësisë

Me ftesë të drejtuesve të Shoqatës Ndërkombëtare të Profesionistëve të Privatësisë (International Association of Privacy Professionals - IAPP) dhe në kuadër të mbledhjes së Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe Privatësisë, Komisioneri, z. Besnik Dervishi, mori pjesë në një sërë aktivitetesh në kryeqytetin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Washington DC.



Agjenda e takimeve dhe aktiviteve përfshinte pjesëmarrjen në Samitin Global të Privatësisë në "Washington Convention Center", me pjesëmarrjen e mbi 4000 profesionistëve të sektorit. Në samit u trajtuan tematika si përgjegjshmëria dhe llogaridhënia e organizatave, nëpunësit e mbrojtjes së të dhënave, privatësia dhe mbrojtja e të dhënave në komunikimet hapësinore, privatësia dhe arsimi i lartë apo media, mbrojtja e privatësisë së nëpunësve sipas GDPR, krahasimi facial, etj.

Një ditë e plotë iu dedikua takimeve ndërmjet Autoriteteve kryesore botërore të mbrojtjes së të dhënave me zyrtarë të lartë amerikanë, duke nisur nga një tur takimesh në Shtëpinë e Bardhë me Abigail Slater, Asistenten Speciale të Presidentit të SHBA për Teknologjinë, Telekomunikimet dhe Politikat Kibernetike; zyrtarë të qeverisë amerikane, nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave të Shtëpisë së Bardhë, etj.

Gjithashtu, takimet vijuan me anëtarë të stafit të Kongresit që punojnë aktualisht mbi



Z. Noah Phillips, Komisioneri i Komisionit Federal të Tregtisë dhe z. Dervishi



legjislacionin federal të privatësisë dhe me politikanë të Shtetit të Kalifornisë, përfshirë Alastair Mactaggart, iniciatorin e Ligjit të Privatësisë së Konsumatorëve të Kalifornisë (California Consumer Privacy Act - CCPA), Komisionerin e Komisionit Federal të Tregtisë, z. Noah Phillips, si dhe takime me organizatat kryesore amerikane dhe ndërkombëtare të shoqërisë civile apo aktiviste të privatësisë, përfshirë "Forumit e të Ardhmes së Privatësisë" ("Future of Privacy Forum" - FPF), anëtarë të Bordit Drejtues të IAPP, etj.

Z. Dervishi mori pjesë në mbledhjen e radhës së Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare, ku njohu anëtarësinë me ecurinë e organizimit të edicionit të 41-të të forumit. Gjithashtu, Komisioneri në cilësinë e bashkëdrejtuesit të Komitetit Ndërkombëtar Këshillimor (PAC) me bashkëdrejtuesin tjetër, z. Peter Hustinx, drejtuan mbledhjen e kësaj strukture. Në përfundim, z. Dervishi ishte i ftuar dhe mori pjesë në takime me z. Marc Rotenberg, President i "Qendrën e Informimit për Privatësinë Elektronike" (Electronic Privacy Information Center - EPIC) dhe z. Stan Crosley nga "Zyrat Ligjore Crosley (Crosley Law Offices)", njëherësh bashkëdrejtues i "Qendrës Ligjore, Etikës dhe Kërkimit të Aplikuar" (CLEAR) të Universitetit të Indianës.



Bashkëpunimi me Autoritetin e Britanisë së Madhe për organizimin e Konferencës Ndërkombëtare



Me ftesë të Zyrës së Komisionerit zhvilloi takime në Tiranë një delegacion i Autoritetit të Informimit të Britanisë së Madhe (ICO), në përbërje të të cilit ishin z. Steve Wood, Zëvendëskomisioner dhe znj. Hannah McCaulsland, kreu i Njesisë së Marrëdhënieve me Jashtë.

Në fokus të diskutimeve gjatë qëndrimit të tyre 2-ditor ishte organizimi i Konferencës së 41-të Ndërkombëtare (ICDPPC). Vëmëndje të posaçme iu kushtua shkëmbimit të ideve dhe mendimeve në funksion të tematikave të përmbajtjes së

këtij aktiviteti. Po ashtu, u diskutua dhe për rolin e Komitetit Konsultativ Ndërkombëtar, që funksionon si një mekanizëm mbështetës i Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare.

Trajnim me stafin e Zyrës së Komisionerit

Me temë "Si organizatat i administrojnë në mënyrë të përgjegjshme të dhënat personale" u zhvillua me stafin e Autoritetit një trajnim me z. Martin Abrams, Drejtorin Ekzekutiv i Fondacionit "Përgjegjshmëria mbi Informacionin Personal" (Information Accountability Foundation) dhe z. Scott Taylor.

Ekspertët amerikanë ndanë me të pranishmit eksperiencat më të përparura në këtë fushë, si në aspektin teorik ashtu edhe atë praktik. Një proces i drejtë dhe transparent përpunimi të dhënash personale është funksional, nëse ka standarde të larta që në fazën planifikuese, e më tej në atë të zbatimit dhe kontrollit të tyre.





Kuvendi miraton Rezolutën për vlerësimin e punës të Zyrës së Komisionerit për vitin 2018

Në seancën plenare të datës 28 mars 2019 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Komisioneri, z. Besnik Dervishi, paraqiti Raportin Vjetor të veprimtarisë së institucionit për vitin 2018. Në përfundim të punimeve të tij, Kuvendi miratoi dhe Rezolutën “Për vlerësimin e punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2018”.

Më herët gjatë këtij muaji, z. Dervishi paraqiti përpara Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, Raportin Vjetor 2018, i cili u vlerësua nga anëtarët e tij. Viti i kaluar ishte dinamik, me përgjegjësi dhe sfida të reja, por edhe një vit i konsolidimit të aktivitetit të Zyrës së Komisionerit me rezultate të prekshme në të dy fushat e veprimtarisë së institucionit.



Forumi “Mbrojtja e të dhënave personale, sfidat e ligjit për biznesin”

Dhoma Amerikane e Tregtisë zhvilloi Forumin e Biznesit me temë “Mbrojtja e të dhënave personale, sfidat e ligjit për biznesin”. I ftuar nderi në këtë takim ishte Komisioneri, z. Besnik Dervishi. E konceptuar si një tryezë e rru-mbullakët, në këtë forum u diskutua rreth zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga sektori privat, për rolin e Autoritetit dhe sfidat kryesore të së ardhmes.



Z. Dervishi i njohu të pranishmit me veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit, duke i kush-tuar vëmendje kompanive që e ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorë me ndjeshmëri të lartë në përpunimin e të dhënave perso-nale. Sipas tij, bashkëpunohet në organi-zimin e vazhdueshëm të aktiviteteve njohëse, trajnuese e ndërgjegjësuese për biznesin. Zyra e Komisionerit vlerëson se niveli i përmbushjes së detyrimeve ligjore ka ardhur gjithnjë në rritje dhe nga ana tjetër, ka vullnet për përmirësimin e pro-blematikave të konstatuara.

Hyrja në fuqi e Rregullores së Përgjithshme (GDPR) në BE dhe modernizimi i Konvetës 108 të Këshillit të Evropës, në maj të 2018, janë dy akte të rëndësishme ligjore që së shpejti do të përafrohen edhe në kuadrin rre-gullator shqiptar. Risitë e tyre vendosin standardet më të larta, përgjegjshmëri të shtuar të biznesit dhe ga-rantojnë siguri për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë e qytetarëve.



Konferenca Evropiane e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave

Më shumë se 70 përfaqësues të Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale u mbledhën në Tbilisi të Gjeorgjisë në edicionin e 29-të të Konferencës kontinentale, ndryshe e njohur edhe si Takimi i Pranverës. Agjenda e aktivitetit ishte e ndarë në 5 panele, përgjatë 2 ditëve të zhvillimit të tij,

ku të pranishmit diskutuan rreth zbatimit të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave 1 vit pas hyrjes së saj në fuqi në vendet anëtare të BE; për modernizimin e Konventës 108 të Këshillit të Evropës; për mbrojtjen e fëmijëve në mjedisin digjital; për mbrojtjen e të dhënave në kuadër të veprimtarisë së organizatave ndërkombëtare; si dhe për të ardhmen e këtij forumi.

Zyra e Komisionerit kontribuoi me prezantim në panelin e dytë të emërtuar **“Konventa 108+ ka nevojë për ju, po aq sa ju keni nevojë për të”**. Në të u dha informacion gjithëpërfshirës në lidhje me risitë e sjella në këtë dukument të KiE, modernizimi i të cilit i përgjigjet procesit të përpunimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale në raport me zhvillimet teknologjike. Znj. Meri Kujxhija diskutoi rreth aspektit global të Konventës 108+, si dhe rëndësinë e saj në forumet e bashkëpunimit global, me fokus të veçantë, Konferencën Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC).



Në panelin 5-të u trajtuan çështje në lidhje me të ardhmen e Konferencës Evropiane, ku Zyra e Komisionerit (edhe në cilësinë e organizatorit të edicionit të kaluar) u përfaqësua me z. Eldor Budo. Të pranishmit ndanë mendimin se ky forum duhe të ketë një strukturë të qëndrueshme dhe të përhershme, ndërsa iu kushtua vëmendje edhe aspekteve teknike të menaxhimit të Konferencës. Nga pjesëmarrësit në panel, u kërkua vlerësimi i ndryshimit të disa dispozitave të Rregullores për përzgjedhjen e organizatorëve të ardhshëm të saj. Gjithashtu, u diskutua edhe për saktësimin e procedurave dhe afateve të depozitimit të projekt akteve për miratim nga anëtarësia e organizatës. Organizator i edicionit të 30-të forumit do të jetë Autoriteti kroat i Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Konferenca pranoi si anëtar me të drejta të plota Autoritetin turk.

“Pyet Shtetin - Merr Përgjigje”, fushata ndërgjegjësuere për të drejtën e informimit

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” zhvilloi takime në kuadër të fushatës ndërgjegjësuere “Pyet Shtetin - Merr Përgjigje”.



Takimet u zhvilluan në Universitetin “Aleksandër Moisiu” në Durrës dhe në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, ku pjesëmarrës ishin studentë, staf akademik e administrativ. Takimi i tretë u zhvillua në Elbasan me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile të këtij qyteti dhe nga Librazhdi. Qëllimi i aktiviteteve është njohja me ligjislacionin për të drejtën e informimit dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për ushtrimin e të drejtave të tyre. Njëkohësisht, i është kushtua vëmendje trajtimit të procedurës për kërkimin e informacionit nga Autoritetet Publike duke përdorur regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve pyetshtetin.al. Të pranishmit shfaqën interes për këtë portal unik, i cili është një instrument proaktiv për njohjen me informacionin publik; ndërsa shprehën interes që pjesë e tij në të ardhmen të jenë të gjitha institucionet shtetërore.



Transparenca e institucioneve të arsimit të lartë

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale z. Besnik Dervishi, zhvilloi një takim me studentë që përfaqësojnë organizatën e shoqërisë civile “Qëndresa Qytetare”.

Komisioneri Dervishi, në vlerësim të kontributit të tyre rreth debatit mbi çështjet studentore, bëri një prezantim të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe atij për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe për rolin dhe funksionet e Zyrës. Në takim u diskutua për transparencën dhe llogaridhënien e Autoriteteve Publike, veçanërisht, për institucionet e arsimit të lartë. Në këtë këndvështrim, Zyra e Komisionerit nxit çdo kontribut për forcimin e kësaj kulture nga organizatat e shoqërisë civile. Ndërsa, vlerëson si shumë të rëndësishme edhe rritjen e ndërgjegjësimin me çdo formë të qytetarëve për ushtrimin në praktikë të të drejtave të tyre themelore.



Takim me Zëvendëspresidentin e Parlamentit Evropian, z. Fabio Massimo Castaldo

Z. Besnik Dervishi priti në një takim pune Zëvendëspresidentin e Parlamentit Evropian, z. Fabio Massimo Castaldo, në portofolin e përgjegjësive të të cilit janë të drejtat e njeriut dhe funksionimi i demokracisë. Komisioneri prezantoi shkurtimisht drejtimit dhe arritjet kryesore në veprimtarinë e Autoritetit. Monitorimi i ligjit "Për të drejtën e informimit" ka sjellë transformimin cilësor të situatës së transparencës së autoriteteve publike. Kjo punë sistematike është kontribut i rëndësishëm në luftën

kundër korrupsionit, një nga 5 prioritetet kyçe të BE për vendin tonë, në kuadër të procesit të integrimit. Në takim u diskutua dhe për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, nivelin e kënaqshëm institucional e administrativ të Zyrës së Komisionerit, si dhe për standardet në legjislacionin shqiptar. Të pranishmit u njohën dhe me hapat në transpozimin e plotë të kuadrit të ri rregullator evropian - Rregullorja e Përgjithshme (GDPR) dhe Direktiva e Policisë (2016/680), në legjislacionin kombëtar shqiptar. Z. Castaldo vlerësoi progresin e arritur dhe konsolidimin e rolit të institucioneve të pavarura, kontributin e tyre thelbësor në integrimin evropian të vendit. Në këtë kontekst, në kuadër të zbatimit të GDPR, ai theksoi rëndësinë e vendosjes së një balance mes zhvillimit ekonomik e social dhe respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të qytetarëve. *"Kjo bëhet akoma edhe më sinjifikative, duke marrë në konsideratë veprimtarinë ekonomike në sektorë të caktuar që kompani nga vendet e BE zhvillojnë në Shqipëri apo ku përfitues janë qytetarët evropianë"* - theksoi z. Castaldo. Zëvendëspresidenti i Parlamentit Evropian ofroi mbështetjen e tij për realizimin në të ardhmen të projekteve me interes integrimin evropian.

Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave dhe kodet e sjelljes sipas GDPR

Me temën "Nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave dhe kodet e sjelljes sipas Rregullore së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE (GDPR)", u zhvillua trajnimi për stafin e Zyrës së Komisionerit. Në të morën pjesë dhe përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike. Trajnimi është pjesë e aktiviteteve të "Projektit të Binjakëzimit Antikorrupsion Shqipëri-BE".



I ftuar si lektor ishte z. Stefan Niederer, nga Autoriteti Federal i Gjermanisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Lirinë e Informimit. Ai prezantoi për të pranishmit rolin dhe funksionet e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave (DPO), në referencë të neneve 37-39 të GDPR, pozicion ky që përfshihet në të gjithë procesin e përpunimit dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale të qytetarëve. Po ashtu, u trajtuan kodet e sjelljes sipas neneve 40-41 të Rregullores së Përgjithshme, të cilat nxisin standarde të larta në informimin, transparencën, përgjegjshmërinë dhe mbrojtjen e të dhënave nga "kontrolluesit dhe/ose përpunuesit".

Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5

Kodi postar 1001

Tiranë

Tel: +355 42237200 Fax: +355 42233977

Nr. i gjelbër: 08002050

www.idp.al

info@idp.al